



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assemble

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 07/2015

Prishtinë, më 3.2.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamt Mustafa, kryetar, Sasha Milosavljeviq, Visar Ymeri, Sala Berisha-Shala, Raif Qela, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca dhe Pal Lekaj, anëtarë.

Munguan: Besim Beqaj, Fatmir Limaj dhe Duda Balje, anëtarë.

Pjesëmarrës i ftuar: Blerand Stavileci, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Pjesëmarrës të tjerë: Vllaznim Krasniqi, Nazmi Zenelaj dhe Ardit Gashi - MZHE, Lumnije Murati - ZPRK, Dardan Abazi - INDEP, Lejla Selim - OSBE, Vlora Nushi - UNMIK/OPA dhe Naim Jakaj – GP/VV-së.

Pjesëmarrës nga mediat: Lirdona Xhemajli - “RTV21”, Bleta Gashi - “RrokumTV”, Beadim Sylja - “Kosova-Press”, Valmir Klaiqi - “Top Channel”, Visar Prebreza - “Koha Ditore” dhe Sylejman Blaku - “Kosova Sot”.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetari i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 27.1.2015;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr.05/L-09 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas pikës të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 27.1.2015;

Procesverbali nga mbledhja e datës 27.1.2015, u miratua me plotësimin dhënë nga kryetari i komisionit, Muhamet Mustafa,

Të kërkohet nga organet kompetente që të shqyrtojnë procedurat e shpalljes së konkurseve për kryeshef ekzekutiv në PTK dhe në Infrakos dhe të informojnë Komisionin për rregullsinë e procedurës në aspektin ligjor dhe përmbajtjesor.

3 Shqyrtimi ne parim i Projektligjit Nr.05/L-09 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha së sjellja nga ana Qeverisë në Kuvend e Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, është mjaftë e rëndësishme në aspektin e zhvillimit ekonomik. Ai theksoi se ne sot do ta trajtojmë Projektligjin vetëm në parim dhe kërkoi sqarim për disa çështje që janë të diskutueshme te disa nene, e posaçërisht në nenin 3, paragrafi 11.3, lidhur me regjistrimin si ndërmarrje publike, që duhet të bëhet në marrëveshje me komunat në territorin e të cilave gjenden ato ndërmarrje, ose njësitë e caktuara organizative të ndërmarrjes shoqërore, të cilat janë objekt i regjistrimit si ndërmarrje publike. Ai pyeti se cili është roli i komunave në këtë rast, dhe për kreditorët e mundshëm lidhur me ndërmarrjen shoqërore “Trepça”? Për këtë pikë të rendit të ditës është ftuar z. Blerand Stavileci, ministër i zhvillimit ekonomik, për të paraqitur arsyetimin e Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Blerand Stavileci, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE), paraqiti arsyetimin e Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Ai tha se çështjet kryesore të trajtuara në këtë projektligj, kanë të bëjnë me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dhe krijimin e bazës juridike, që me vendim të Kuvendit të Kosovës të hiqet nga kompetenca e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) ndërmarrje të caktuara shoqërore ose njësi të caktuara organizative të një ndërmarrje shoqërore dhe këto të regjistrohen si ndërmarrje publike. Ai theksoi se arsyeja pse kemi ndërmarrje ndryshimin dhe plotësimin e këtij projektligji është që të hapim rrugë krijimit të ndërmarrjeve të reja, që kanë të bëjnë me interesat përgjithshme të publikut, e në veçanti për t'i shërbyer zhvillimit ekonomik të qytetarëve. Për rolin e komunave që është nenin 3, paragrafin 11.3, ideja është së kanë shumë nevoja komunat për interesat publike, për t'i dhënë ma shumë hapësirë për bashkëpunim të nivelit qendror më atë komunal, për çështjet që kane të bëjnë me interesat e qytetarëve dhe proceset e zhvillimit ekonomik, të mos jenë peng nga komunat e caktuara dhe për këtë arsye kemi paraparë që për krijimin e ndërmarrjeve të reja publike, të kemi marrëveshje dhe konsultime me komunat, sepse ky projektligj i trajton vetëm aspektet zhvillimore dhe jo aspektet politike. Ndërsa për ndërmarrjen shoqërore “Trepça”, ai ceku se pas miratimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit, për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, dhe zgjatjes së afatit për likuidim të ndërmarrjes shoqërore “Trepça”, tani kemi kohë të arsyeshme për të marrë hapat e duhur për hartimin e Ligjit të veçantë për “Trepçën”.

Blerim Grainca kërkoi një interpretim më të detajuar për nenin 3, paragrafi 11.3. Po ashtu, ai tha se Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nuk ka

paraparë rregullimin e bordeve për ndërmarrjet publike, qoftë ato qendrore dhe lokale, ku në ligjin bazik disa gjëra duhet të jenë më të qarta.

Visar Ymeri tha se në qoftë se krahasojmë projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, që ishte para dy javëve, me këtë që është sjellë tani, është një dallim tejet i madh, sepse në atë projektligj ishin për amendamentim vetëm dy nene dhe ishte qëndrim i të gjitha grupeve parlamentare që të miratohet, më përjashtim të vetëm grupit parlamentar “lista serbe”. Ymeri theksoi se nënen 3, paragrafi 11.3, krijon implikime juridike nëpër Komuna. Në këtë nen thuhet që duhet të ketë një marrëveshje me komunat, konsultimi dhe marrëveshja janë të kundërta, marrëveshja është obliguese, sepse deri ma tani në procesin privatizimit, edhe për asnjë ndërmarrje publike, nuk janë pyetur komunat. Ndërsa për ligjin për “Trepçën” nëse hartohet, nuk mund të bëjë ndesh më ligjin për ndërmarrjet publike dhe nuk kemi ndonjë afat se kur vjen në Kuvend. Ymeri kërkoi që Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, të mos dorëzohet në këtë formë për seancë plenare, pasi që nuk është miratuar në këtë formë në mbledhje të Qeverisë dhe janë dy versione.

Blerand Stavileci, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE), tha që me miratimin e Ligjit, për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, e kemi shpëtuar “Trepçën” nga likuidim. Ai tha se edhe me Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, po i hapët rruga “Trepçës” për një zhvillim ekonomik. Dhe është parim universal i drejtësisë, ku thuhet se ligjet speciale vlejnë më shumë se ligjet përgjithshme. Stavileci theksoi për nënen 3, paragrafi 11.3 se duhet të riformulohet më mirë dhe nuk ka ndonjë prapavijë politike dhe se ky ligj duhet të jetë në interes të të gjithë qytetarëve.

Visar Ymeri pyeti se a ka pas falsifikim të Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, dhe a është votuar ky tekst që e kemi sot në mbledhje të qeverisë, apo është ndryshuar teksti?

Kryetari i Komisionit tha që ky nen nuk është precizuar mirë, sepse roli i komunave duhet të definohet më qartë dhe gjatë amendamentimit do ta qartësojmë dhe riformulojmë më mirë.

Fatmir Rexhepi tha se Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, është qëllimshëm, por nuk është menaxhuar si duhet se cili është qëllimi i vërtetë. Ai theksoi për hapat që duhet të ndërmerren në këtë projektligj gjatë shqyrtimit, në mënyrë që t’ju krijojmë hapësira të nevojshme komunave për nevojat e qytetarëve dhe interesat publike, aty ku kanë mbetur ende hapësirat shoqërore pa u privatizuar, të kalojnë në pronësi të komunave në mënyrë që të zhvillohen komunat. Ai propozoi për nënen 3, paragrafin 11.3, të riformulohet në vend të marrëveshjes të jetë në konsultim me komunat dhe që brenda 6 muajve ta kemi projektligjin e veçantë që rregullon çështjen e “Trepçës” duke thënë se në paparim është për miratimin e projektligjit.

Raif Qela tha se pas miratimit të Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit, për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, ky është vetëm një hap që ka parandaluar likuidimin e aseteve të “Trepçës” dhe tani e kemi nxjerr prej humnerës dhe duhet të krijohen kushte për një zhvillim ekonomik, për pjesën e “Trepçës” që gjendet në veri të Mitrovicës. Janë lejuar investimet në flatacion nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, por nuk janë lejuar investime në jug nga AKP-ja. Ndërsa theksoi se Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, duhet të precizohet koha se kur do ta nxjerrim ligjin e veçantë për “Trepçën”, për nënen 3, te paragrafit 11.3, propozoj që në vend të fjalës marrëveshje të bëhet në harmoni komunat, tha Qela.

Pal Lekaj tha se sa i përket shqetësimit publik për ndërmarrjen shoqërore “Trepça”, duhet të thuhet e vërteta dhe të jemi korrekt me opinionin publik se çka po ndodhë me “Trepçën”. Ai tha se neni 3, paragrafi 11.3, të precizohet saktë ky paragraf, kur thuhet se regjistrimi i ndërmarrjeve publike bëhet në marrëveshje me komunat, sepse ky nen bie ndesh me disa ligje që rregullojnë sferën e komunave, siç është ligji për vetëqeverisjen lokale, duhet të listojmë listën për cilat ndërmarrje publike duhet që të ketë marrëveshje për regjistrim me komunat. Propozoj që te paragrafi 11.3, i nenit 3, të fshihet fjala në marrëveshje me komunat, pas që qëndrimi është së komunat të mos jene fuqiplote në vendimmarrje, sa i përket ndërmarrjeve të nivelit qendror, që rregullohen me ligjin për ndërmarrjet publike.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se do ta rregullojmë këtë nen, aty ku është marrëveshje të bëhet në konsultim me komunat, edhe këtu bëhet fjalë edhe për ndërmarrjet lokale.

Blerand Stavileci, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE), tha që për ndërmarrjet qendrore dhe lokale, komunat duhet të përfshihen patjetër në konsultim, sepse bëhet fjalë për interesin e publikut dhe qytetarëve.

Pal Lekaj tha se këto çështje duhet të rregullohen me ligj, se për ndërmarrjet lokale janë përgjegjëse komunat, ndërsa për ato qendrore, qeveria, ndërsa ndërmarrjet shoqërore duhet t'i trajtojmë veç e veç, në bazë të interesit të përgjithshme të publikut.

Sala Berisha-Shala tha se sa i përket nxjerrjes së ligjit të veçantë për Kombinatin “Trepça”, këtë e kam propozuar në planin e punës për vitin 2015, që të hartojmë në komision, pasi që procedurat për nismat e hartimit të ligjeve në Kuvend janë shumë më të lehta, dhe mund të përfundojmë shumë më shpejt. Propozoj që neni 3, paragrafi 11.3, i Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, gjatë fazës së amendamentimit të diskutohet në detaje se cili është qëllim i këtij neni.

Sasha Milosavljeviq tha se do t'i precizojmë me amendamentim të gjitha dilemat që u ngritën dhe në parim pajtohem për miratimin e Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Visar Ymeri tha që mund të amendamentohet projektligji, por duhet të ketë edhe një vullnet nga ana e Qeverisë. Pastaj, tha që duhet të insistojmë nga Ministra e Zhvillimit Ekonomik si sponsorizuese e projektligjit, që të kemi një përgjigje, lidhur me pyetjen që ja bëra **Blerand Stavileci**, ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, se a është ndryshuar teksti i projektligjit, i cili është miratuar në qeveri, të cilën përgjigje nuk e morëm nga z. Stavileci.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, i njoftoi anëtarët e Komisionit me takimin që ka pasur me disa ekspertë, lidhur me Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, ku është konsultuar që të gjejë mënyrën më të mirë në aspektin juridik. Mustafa theksoi se këto çështje sot i trajtuam vetëm në parim dhe gjatë shqyrtimit në grupin e punës, kemi kohë për 2 muaj, do ta shqyrtojmë nen për nen. Në fund të mbledhjes ai propozoi që të themelohet një grup i punës për Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Pas debatit, Komisioni me 6 (gjashtë) vota për, 1 (një) kundër dhe 1 (një) abstenim, nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji Nr.05/L-09 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Komisioni, Kuvendit ia paraqet këtë

Rekomandim

Të miratohet në parim, Projektligji Nr.05/L-09 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Komisioni vendosi që Grupi i punës për shqyrtimin e këtij projektligji, të jetë më këtë, përbërje: Muhamet Mustafa, kryesues, Visar Ymeri, Sasha Milosavljeviq dhe Sala Berisha -Shala, anëtarë.

4. Të ndryshme.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, i njoftoi anëtarët e Komisionit së për mbledhjen e radhës do të ftohet për raportim znj. Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, cila do të raportojë në veçanti për ambientin e biznesit dhe nxitjen investimeve.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa